



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL Nr.12
Datë 24.12.2025 ora 10 : 00 ^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.5519.Prot datë 19.12.2025, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.11.2025.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për “Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”.
- 6- Shqyrtim dhe miratim i Realizimit Faktik të Buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Rrogozhinë.
- 7- Shqyrtim dhe miratim i Relacionit të Buxhetit Afatmesëm 2026 - 2028 për Bashkinë Rrogozhinë.
- 8- Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar”.
- 10- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Bursave të nxënësve të arsimit profesional”.
- 11- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026”.
- 12- Miratim i projekt - vendimit, “Për shpalljen qytetar nderi Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj”.
- 13- Shqyrtim i dy kërkesave të anëtares së këshillit bashkiak znj. Silvana Aliu.
- 14- Raporti i performancës së Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024.
- 15- Të ndryshme.



- Shqyrtim i kërkesë-ankesës së znj. A. Sula.
- Të tjera.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Mitat Daja, Sokol Gosa, Saimir Cani, Merilin Saraçi, Lije Dedej, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

(znj. Merilin Saraçi i bashkohet në vijim mbledhjes së Këshillit).

Mungojnë :

Dhurata Meka, Lorena Baku, Altin Tosku, Shpati Kolgega, Besnike Coraj.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Astrit Mertiri - Administratori i Njesisë Administrative Kryevidh.
4. Deshir Gjumsi - Administratori i Njesisë Administrative Lekaj.
5. Denis Sako - Administratori i Njesisë Administrative Gosë.
6. Mexhit Saliu - Administratori i Njesisë Administrative Sinaballaj.
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
11. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
12. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
13. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vadtjes.
15. Nuredin Tosku - Përgjegjës i Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë
16. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.



Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 15- Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Erind Tosku, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Mitat Daja, Sokol Gosa, Saimir Cani, Lije Dedej, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 26.11.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 43 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%

Vendim nr . 44 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 45 . Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë.

Vendim nr . 47 . Për miratimin e kërkesës së z. Hekuran Dedej.

Vendim nr . 48 . Për shpalljen “Qytetar Nderi” i Rrogozhinës (pas vdekjes) z. Ramazan Thartori.

Gjithashtu lexojmë dhe konfirmimin ligjor të ardhur nga prefekti i qarkut Tiranë për vendimet e datës 26. 11.2025:

Vendim nr . 46 . Mbi sistemin e taksave dhe tarifave vendore viti 2026 për Bashkinë Rrogozhinë Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe VKM-së nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa” e bazës së taksës për kategori specifike natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave përcaktimin e bazës së taksës për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar.



Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Prefekt : Afrim Qëndro.

Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës ju kam dërguar dje në grupin e këshillit në WhatsApp, Projektvendimin “Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar“, i cili pas rekomandimit të dalë nga mbledhja e komisioneve të këshillit që u zhvilluan dje, si dhe pas plotësimit të kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm, në listën e përfituesve të bursave u shtua dhe një nxënës tjetër dmth numri total u bë nga 41 në 42.

Dokumenti tjetër është projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor” pika 4, për të cilin ishit njoftuar që ishte në fazë përpunimi.

Dhe Projektvendimi shtesë “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor”. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim dhe ta shqyrtojmë në pikën të ndryshme të rendit të ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro... Miratohet?

-Miratohet me 12-vota pro, përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit, “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor”.

Mukades Gixhari . Tani na kanë ardhur dy kërkesa që do ju bëj me dije kemi një kërkesë për dorëheqje nga z. Mitat Daja. Unë i nënshkruari Mitat Daja Kryetar i Komisionit për çështjet juridike, rend, konflikte paraqes dorëheqjen time si kryetar i këtij komisioni.

Dhe kërkesa e dytë është e z. Enver Memolla, Unë i nënshkruari Enver Memolla anëtar i komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit paraqes dorëheqjen time si anëtar i këtij komisioni. Tani na mbetet ne detyrë që këto dy zotërinjtë që u larguan këshilltarët që u larguan t’i zëvendësojmë me dy të tjerë. Faleminderit.

Kalojmë në rendin e ditës . Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim pro...? Ndjesë kemi një ndryshim tek pika 5 se u mbledh kryesia para mbledhjes që është për miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për “Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”. Pasi kemi... dosja që ka ardhur është me emrin e zonjës Arta Sula ka ardhur i biri sot është kërkesë ankesë që do të thotë dy fjalë rreth dosjes së tij të kësaj çështje që ka dmth që ta diskutojmë në pikën 5 nga 15 që e kemi. Jeni dakord? Në rregull.

-Miratohet me 12-vota pro, diskutimi në pikën 5 të rendit të ditës të të birit të znj. Arta Sula rreth kërkesë ankesë së bërë nga ana e tij, pasi dhe objekti i pikës 5 ka të bëjë me problematikën e paraqitur nga qytetari.



Mukades Gixhari . Fillojmë me miratimin e rendit të ditës. E hedhim në votim pikën 1, të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim, të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.11.2025. E hedhim në votim pikën 2, të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim, të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 2 (dy) e rendit të ditës.
(Nuk ndodhen në sallë në këtë votim këshilltarët znj. S. Aliu, z. I. Dedej, z. Mitat Daja)*

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Përshëndetje !Atëherë në total janë 16 familje dhe fondi është 69 mijë lekë.

Mukades Gixhari . E keni të gjithë materialin përpara. Ndonjë pyetje për z. Ledian. E hedhim në votim pikën 3, të rendit të ditës. Pro kundra absenim të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.
(Nuk ndodhen në sallë në këtë votim këshilltarët znj. S. Aliu, z. I. Dedej, z. Mitat Daja)*

Vendim nr. 49. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5512.Prot datë 19.12.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5512/1.Prot datë 19.12.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton po drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 31 familje dhe fondi është 147 mijë lekë të reja, përfshirë dhe fëmijët që janë me një prind.

Mukades Gixhari . Fjala për z. Enver Memolla .



Enver Memolla . Kam një pyetje për këtë situatën e shpërblimeve .

Ledian Hasani . Akoma nuk na ka ardhur VKM-ja është cilësuar 150.000 lekë... nuk ka ardhur VKM-ja dhe ne bazohemi te VKM-ja që të bëjmë gati listë pagesat.

Enver Memolla . 6%, 3% përfitojnë?

Ledian Hasani . Jo këto nga fondet e bashkisë jo, kurse 6% përfiton.

Enver Memolla . Uroj që ta mbyllim para vitit të ri sepse i bie që nesër je pushim e premtë...

Ledian Hasani . Atë duam edhe ne që të mbyllim që edhe njerëzit ta marrin atë shpërblim para vitit të ri nëse na vjen sot që sot e mbyllim ne qoftë se vonohet pastaj s'kemi çfarë bëjmë se do bazohemi diku që të...

Enver Memolla . Prandaj pyeta ka ardhur VKM-ja apo jo.

Mukades Gixhari . Faleminderit zoti Enver pyetje tjetër, pyetje tjetër . Jo, këshilli jo. Atëherë e hedhim në votim pro, kundra, abstenim, të gjithë pro miratohet.

*-Miratohet me 14 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.
(Nuk ndodhen në sallë në këtë votim këshilltarët , z. Mitat Daja)*

Vendim nr.50. Miratohet me 14-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.5544.Prot datë 22.12.2025, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5544/1.Prot datë 22.12.2025.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë tani me pikën pesë. Miratimi i projektvendimit për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të paforizuara. Dhe për këtë do të na relatojë po drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani dhe është ajo që jua thashë në fillim që kryesia e shqyrtoi kërkesën e zotit Taulant Sula. Kërkesë ankesë që të japim fjalën atëherë dëgjojmë drejtorin...

Ledian Hasani . Atëhere gjithsej kanë aplikuar shtatë familje nga këto shtatë familje tre kemi cilësuar ne që janë janë banesa që janë të amortizuara që mund të hyjë qeveria. Katër domethënë tek të shtatë familjet është ngritur një komision nga kryetari i bashkisë nga tre përfaqësues të



zyrës urbanistikës dhe dy përfaqësues të tjerë nga bashkia. Komisioni ka vendosur që tre familje i plotësojnë kriteret për të përfituar nga projekti. Katër të tjerat pastaj janë njoftuar me anë të shërbimit postar të katërta këto familje. Domethënë tre familjet që janë përfituese kanë dëmtime të theksuara, katër të tjerat pastaj normalisht janë në kushte të mira.

Indrit Dedej . Led ta bëj një pyetje është një familje... (nuk dëgjohej) ti e ke në lagjen tënde.

Ledian Hasani . Po, e kam në lagje.

Indrit Dedej . Ky nuk ka përfituar as nga varrezat që u shembën atëherë...

Ledian Hasani . Po ajo është bërë procedura atëherë para 13 vitesh duket është bërë madje dhe më përpara 12 vitesh është bërë kur ka qenë Haqim Tosku kryetar.

Indrit Dedej . Shtëpia është e pabanueshme.

Ledian Hasani . Jo jo... janë prishur varrezat është shebur shtëpia. Nuk e di çfarë faze janë nuk di çfarë të them nuk jap dot informacion për diçka...

Indrit Dedej . Shtëpia është e pabanueshme.

Ledian Hasani . Ta verifikojmë ta shohim në qoftë se është për emergjencat pastaj...ta shikojmë, Të shohim çfarë mund të bëhet.

Mukades Gixhari . Po zonja Silvana.

Silvana Aliu . Ka ardhur një ankimim nga një person.

Edison Memolla . Mbaroni të gjithë dhe leni për pyetjen e fundit ta dëgjojmë.

Mukades Gixhari . Z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Kryetare në projektvendim vura re dhe sot që mungon grupi i punës i ngritur nga kryetari i bashkisë.

Ledian Hasani . Grupi i punës është nëpër dosje, procesverbalet që kemi mbajtur ne janë nëpër dosje të qytetarëve të gjithë dokumentacioni është nëpër dosje. Nuk mund t'i sjellim ato presverbale këtu në projektvendim.



Enver Memolla . Procesverbalet në momentin që kërkohen ...

Ledian Hasani . Aty është procesverbali unë jua tregova edhe dje tek dosjet... Ta tregova dhe VKM-në pse përfitojnë aq.

Edison Memolla . Thjeshtë do të ketë bashkangjitu kush është komisioni që ka mbajtur..

Ledian Hasani . E ka Silvana se po e shoh... apo s'është ajo?

Enver Memolla . Nuk është çështje përplasjesh është thjeshtë çështje për ta kuptuar. Në momentin që ke një komision unë nuk dua ta drejtoj pyetjen ty, por do ja jap kryetarit të komisionit këtë verifikimin.

Ledian Hasani . Drejtori i urbanistikës është kryetar i komisionit.

Enver Memolla . Unë këtë po them...

Ledian Hasani . S'ka problem përderisa unë jam pjestëtar aty ta jap përgjigjen. Nuk besoj që është e nevojshme të jetë ai. Gjithsesi nuk është problem të jetë edhe ai.

Mukades Gixhari . Faleminderit, zoti Erind Tosku.

Erind Tosku . Unë doja dhe unë e shikoj prapë si mungesë dokumentacioni këtë pjesën atje vlera e financimit. Normalisht edhe kjo vlera e financimi ka dhe zëra.

Ledian Hasani . Ato bëhen mbrapa .

Erind Tosku . Sepse keni bërë, pra keni bërë vlerën këtu ... po si del vlera kur bëhen mbrapa

Ledian Hasani . Po pra kjo është udhëzimi që na sjell qeveria me...

Erind Tosku . Pse se kanë të gjithë të njëjtën shumë? Na trego shkallëzimin si funksionon që ta kuptojmë si funksionon “a-ja”, “b-ja”.

Ledian Hasani . Atëherë si fillim shkojnë... atëherë s'kam të njëjtën vlerë sepse ajo që është me vlerën më të madhe ka dy anëtarë në familje, dhe normalisht ajo është më me pak metra diku te 37 m me sa mbaj mend unë.



Erind Tosku . 35.

Ledian Hasani . Ajo ka përfitimin më të madh sepse udhëzimi i qeverisë na thotë kështu, kështu na drejton.

Erind Tosku . Po pra këtu nuk janë përcaktuar zërat.

Ledian Hasani . Jo zërat jo, zërat mbasi lista shpallet përfituese në ministri atëherë pastaj ne bëjmë preventivat.

Silvana Aliu . Kam një vërejtje pak a shumë dhe për ty por më shumë për kryetarin, kryetar nuk të duket pak me 25 familje që kanë ardhur në tre familje. Ose ndoshta është dashur pak më shumë vullnet nga drejtoria sepse ti je në dijeni në kush familje janë në nevojë kush familje janë me atësi të kufizuar. Jo gjithmonë ndeshemi me atë që ne e kemi nxjerrë lajmin ore as unë që jam mësuese nuk di nëpër Facebook të shoh lajmet e gjërave që ndodhin. Nuk e di ti ke filan familje unë po shkoj sepse ka invalidë, dilni në terren.

Ledian Hasani . Po normal që dalim.

Silvana Aliu . Po si ka mundësi nga 25 në 3?

Ledian Hasani . Atëhera e para herë është sepse shumë...

Edison Memolla . Përsëritet të gjithëve. Unë jam, kam qenë dhe jam i hapur që këto lista mos jenë me tre veta nuk ka dhe 25 nuk është në limit. Mund të shkojë edhe më shumë, atëherë nga diskutimet që ato tek ministria hap një kuotë për të gjithë Shqipërinë. Kush plotëson dokumentacionin e duhur 20, 30, 40, 50 do i dërgosh atje. Pastaj ato të japin një miratim thotë 20 do i marri bashki Rrogozhinë 20 do i marri bashki tjetër i shpërndajnë në gjithë Shqipërinë. Unë nuk jam kundër që të jenë, ne kemi bërë mbledhjet të herë pas herë dhe ja kam thënë dhe drejtorit të mirëqenies që ju lutem merrni fusni sa më shumë familje por nëse nuk plotësohet dokumentacioni dhe këto kanë hallet e tjera se s'mund të mbajmë disa siklete që s'na takojnë ne t'i mbajmë, janë disa rregullore që duhet të përshtatim sepse fondet që... Ne nuk harxhojmë bashkia nuk harxhon asgjë përveç se përfiton, bashkia ne si bashki, plus edhe qytetari që me të vërtetë ka nevojë, asnjë nuk aplikon kot nëse nuk ka nevojë. Kështu që është pak, si ta them është pak e koklavitur dhe si gjë që të të përfitojnë të gjithë pa dallim edhe pa dokumentacion.

Silvana Aliu . Pra nuk ka vullnet besoj se do kishim më shumë familje sepse ka me



dokumentacion që kemi gjetur në Gosë me dokumenta familje me invalidë pse nuk e kemi pse e kemi.

Ledian Hasani . Shiko ne programin e kam hapur në këshill si program edhe juve ju kam njoftuar.

Silvana Aliu . Terren o Led.

Ledian Hasani . Në terren kemi dalë, e para herë disa familje që kanë dokumentacion janë të përfshira tek tërmeti DS4, DS5 dhe normalisht ato nuk kanë interes që të përfitojnë te ky lloj programi po kanë interes që t'i bëhet shtëpia, siç do i bëhet.

Erind Tosku . Këto familje që marrin ndihme ekonomike që nuk ka domethënë tre dalin nga këto që i japin bashkia ndihmë ekonomike të gjithë janë në kushte të favorshme te kjo lista që kemi ne, 15 familje 20 familje nuk ka një tjetër të dali katër të bëhet katër.

Ledian Hasani . Po s'kanë edhe dokumente pronësie, i mungon çertifikata e pronësisë që është kusht. Ne vuajmë shumë me pjesën e dokumentacionit për...

Mukades Gixhari . Z. Hekuran Xhani.

Hekuran Xhani . Për sa u tha më sipër jam dakord për këto 3 familje që të trajtohet, gjithashtu të shihet hapësira të përfitojnë sa më shumë familje që realisht e meritojnë, problemi im është sepse shkaktari i kësaj liste me tre persona është çështja e çertifikatës së pronësisë. Këto familje që janë në nevojë këto s'janë në gjendje... problemi qëndron si duhet ta zgjidhim çështjen e pronësisë së këtyre familjeve që faktikisht e meritojnë sepse nuk është faji i këtyre familjeve që nuk përfitojnë është faji i politikave qeverisë qëndrore e cila sa herë vjen në pushtet i premtton qytetarëve shqiptarë legalizim falas. Pra kemi 30 vjet që i gënjejmë shqiptarët do me të ardhur nesër në karriket e pushtetit ne e legalizojmë falas edhe tashi këto jenë njerëz në nevojë, janë njerëz që s'janë gjendje të ndërtojnë shtëpinë e vet e jo të shkojnë të gjejnë pronësinë e shtëpisë. Unë them që në rast se ekziston hapësira ligjore si këshill për këto familje sepse ato taksën e banesës e paguajnë në hartën demografike të bashkisë janë, tani për një dokument ato sot penalizohen nuk përfitojnë atë çfarë ky shtet i jep në ndihmë. Megjithatë dhe kryetari është këtu sepse i kemi premtuar këtyre qytetarëve legalizim falas bëmë dhe një për legalizimin nuk e kush që ishte këshilli këtu, ndërtuar sa legalizime janë bërë. Dhe nuk është faji i qytetarëve që nuk përfitojnë, është faji i pushteteve që nuk funksionojnë, prandaj të shihet kjo e dhe ajo listë me 25



për mua të plotësohet edhe brenda e këtyre ditëve sepse jemi në shërbim të qytetarëve edhe administrata edhe ne si të zgjedhur përfaqësues të tyre.

Mukades Gixhari . Faleminderit zoti Hekuran, zoti Enver..

Enver Memolla . Kryetare marrë shkas se e bëra dhe dje pyetjen drejtorit, këto katër që 4 dosje që janë skualifikuar kanë të drejtë ankimi dhe rivlerësimi?

Ledian Hasani . Atëherë ato do të kishin të drejtë ankimi në qoftë se do t'i kishte skualifikuar komisioni i strehimit për efekt dokumentacioni por ato janë skualifikuar nga një komision tjetër që ka lidhje me strukturën e banesës. Normalisht në këtë komision është drejtori i urbanistikës përgjegjësi urbanistikës .

Enver Memolla . Është e drejtë për të ankimuar për të rivlerësuar apo jo?

Ledian Hasani . Jo, jo .

Enver Memolla . Të dëgjojmë ankimuesin.

Mukades Gixhari . Po z. Taulant.

Taulant Sula . Përshëndetje të gjithëve! Unë quhem Taulant Sula, mbaj këtë dokument me shkronja J40623047A jam banor i fshatit Sinaballaj. Jam këtu sot për të përfaqësuar, nënën time e cila ka bërë një aplikim tek programi social për përmirësimin e kushteve të banesës. Do t'ia nis dhe sekretarit sepse nuk kam printuar materiale për të gjithë që të shikojnë pasi këto janë printuar bardhë e zi.

Ervis Shera . Është ajo që ke dërguar në email?

Taulant Sula . Po.

Ervis Shera . Nëse është ajo, është printuar për të gjithë .

Taulant Sula (qytetar ankues). Ajo që unë vura në dispozicion tani është një akt ekspertimi që familja në fjalë ka bërë me një ekspert ka bërë me një ekspert të fushës e ka bërë me një inxhinier ndërtimi. Nuk është vendosur në fund emri i tij pasi në këto në këtë program nuk e ka barrën personi i cili ka aplikuar, por vetë institucioni ka detyrë që të bëjë këtë grupin e inspektimit. Dhe



nëse kjo do të më lihet barra për të nxjerrë unë për të arritur në këto konkluzione që ju i keni aty, unë jam i disponueshëm që përveç vlerave monetare që janë shpenzuar deri tani nga familja për grumbulim të dokumentacionit dhe deri në ardhjen mundësimin tim në ditët e sotme jam i gatshëm që ta bëj dhe këtë gjë. Si ka nisur procedura? Është bërë një njoftim sipas njoftimeve zyrtare tek ëbsajti i bashkisë edhe tek faqja zyrtare e Facebookut, është bërë një aplikim dhe është pasur një bashkëpunim serioz dhe korrekt me zyrën sociale në pjesën deri në pjesën e grumbullimit të dokumentacionit. Është kaluar faza e parë që kjo familje të përfitojë dhe është njoftuar më pas familja që është kaluar në fazën e parë. Ky njoftim është bërë përsëri në ëbsajtin e faqes së bashkisë kur në fazën e parë kanë kaluar shtatë familje nga 15 foto që kanë qenë në total. Ndër këto shtatë familje ka qenë dhe familja në fjalë pra e mamit tim. Më pas jam njoftuar për pjesën e grupit të inspektimit që ka mbërritur në banesën që bëhet fjalë në datën 10 nëntor të vitit 2025. Më pas ka ardhur një njoftim nga posta shqiptare më datën 15. 11. Ju lutem pak vëmendje te pjesa e datave pra me 11 ka qenë prezent dhe jemi njoftuar rreth 10 minuta përpara se grupi i punës të vinte tek banesa. Faktikisht në banesë nuk ndodhej, asnjë person i familjes, pra as mami që jeton aty dhe as motra e cila është studente në Tiranë. E kemi gjetur një mundësi duke qenë se mami ka kontaktuar kunatën e cila ndodhej afër në banesë edhe ka pasur dhe aksesin pra hapjen e çelësit, në momentin e mbërritjes së grupit të inspektimit kanë qenë prezentë katër persona që më vonë këtu është mësuar që kanë qenë prezent pesë persona. Në fakt personi që nuk ka qenë prezent quhet zoti Tomor Thartori i cili është një person për shkak të një lidhje të largët, krushqie është i identifikueshëm nga personi që ka qenë në banesë. Pra për shkak të një lidhje të largët Krushqie është një person i identifikueshëm. Besoj se është prezent këtu dhe...

Ledian Hasani . Tomorri ka qenë aty, të pestë kemi qenë në banesë, që të pestë.

Taulant Sula . Personi që bëhet fjalë që ka i ka pritur këto quhet Bakushe Sula, është një person me profesion infermiere dhe punon në qendrën Qendrën shëndetësore Sinaballaj është një person i përgjegjshëm, i aftë fizikisht, mendërisht me sy dhe me veshë, kanë qenë katër persona.

Ledian Hasani . Pesë persona, ti s'ke qenë vetë aty. Ti s'ke qenë vetë, thua s'kam qenë vetë tani...

Taulant Sula . Të lutem personi përgjegjës...

Edison Memolla . Mbaroje të gjithë që të kthejmë përgjigje.

Taulant Sula . Keni qenë katër persona.



Ledian Hasani . Pesë, që kanë firmosur aty kemi qenë të pestë, unë kam qenë vetë aty.

Indrit Dedej . Lëre të mbarojë ne nuk të besojmë as ty as atë.

Hekuran Xhani . Mos e ndërpresim ta dëgjojmë dhe dalim në konkluzione.

Taulant Sula . Tani me datën 15 unë kam marrë njoftim nga posta dhe jam marrë dijeni për këtë skualifikim nga ky program dhe konkretisht aty është shkruar atëherë aty është shkruar nga verifikimi i bërë i pasurisë kaq e kaq, rezulton se banesa thotë është në gjendje të mirë konstruktive. Fjala konstruktive nuk e di çfarë duan të thonë dhe është e mirëmbajtur pjesërisht është e pajisur me dyer, dritare dhe pllaka, mbulesa është me solet betoni e cila nuk kishte problematika të theksuara sa i takon lagështirës që mund të vijnë si pasojë e çarjeve krisjeve të betonit. Në tërësinë e saj banesa thotë është me bojë këtu me të zeza i përmbush kushtet për të qenë e banueshme. Nuk e di që në këtë program janë është cituar shprehësisht që duhen banesa që nuk i përmbushin kushtet. Programi thotë përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese. Vi pak tek historiku tek historiku tani të banesës, bëhet fjalë për një banesë e cila është ndërtuar në vitin 95-96 me mundësitë që ka pasur kjo familje normalisht me problematika të dukshme të pjesës së ndërtimit të cilësisë së të gjitha gjërave. Pas dy tre vitesh është bërë një shtesë një tualet pasi në atë kohë nuk ka qenë pjesë e projekteve të tualetit i përfshirë në banesë.

Edison Memolla . Dil tek përfundimi çfarë kërkon, çfarë kërkon ju se i kanë të gjithë dokumentet.

Ledian Hasani . Thuaji që ke përfituar dhe DS3,

Taulant Sula . Do ta citoj... është e detyrueshme që unë të bëj një kronologji për pjesën tjetër që nuk e ka,

Edison Memolla . Të dalim tek konkluzioni çfarë kërkon nga këshilli.

Taulant Sula . Është shumë shumë e qenësishme pjesë që të dëgjoni...

Edison Memolla . Tani s'kemi gjë personale me askënd.

Taulant Sula . Tani banesa në fjalë në vitin 2021 është ngritur një grup pune nga bashkia për verifikimin e banesave që janë prekur nga tërmeti. Banesa është prekur nga tërmeti dhe ka përfituar një fond limit prej 5 milion lekësh të vjetra. Me këtë fond të përfituar atje janë bërë disa



punime të cilat edhe këto unë i kam vënë në dijeni dhe është bërë tek pjesa e një dhome, tualeti, dhe është bërë një izolim i taracës i cili duke qenë se bëhet fjalë që ka qenë një fond limit ne besoj se jemi koshtient që 5 milion lekë të vjetra sot nuk rregullohet një tualet në këtë kuptimin e fjalës me çmimet me shpenzimet që merr pjesa e hakut të punëtorëve.

Fatmira Thartori . Tek pjesa e DS3 ju kishit përfituar.

Taulant Sula . Është bërë një pjesë e punimeve dhe punimet që janë kryer janë nuk është bërë ri tualet është bërë një grryerje e punimeve e sovase ekzistuese është bërë me një bojë nëse këtu kemi një inxhinier ndërtimi është bërë me një bojë e cila quhet beton kontakt për të bërë lidhjen. Është vendosur një pjesë kolle është vendosur një rrjetë sepse atje ka pasur ...

Indrit Dedej . Ka mundësi mos na japësh shpjegim sepse puna e tërmetit ne të gjithë edhe shumë familje që mund të kemi përfituar nga ai, kanë përfituar nga tërmeti, kështu që ne s'kemi pasur asnjëherë pjesë tërmeti, s'ke të kapësh fare me tërmetin... të kapësh vetëm për problematikën që ka shtëpia.

Taulant Sula . Problematika është sepse duke qenë se ky grup...

Indrit Dedej . Nëse ne bashkia na vë në dispozicion listën e tërmetit atëherë ne kemi të drejtë të bëjmë pyetje.

Ledian Hasani . Ai po e deklaron vetë që është përfitues.

Taulant Sula . Problemi është se ka pasur një fond limit prej 5 milion lekësh të vjetra dhe me këto janë bërë kaq punime.

Indrit Dedej . Ne këtu nuk kemi as inxhinier ku e ke inxhinierin, drejtues komisioni inxhinier ne nuk kemi fare sa inxhinier as staf...

Edison Memolla . Indrit ta mbarojë një minutë se do japim përgjigje. Çfarë kërkon nga këshilli bashkiak.

Hekuran Xhani . T'i japim mundësinë ta mbarojë fjalën.

Taulant Sula . Tani është e rëndësishme pjesa kronologjike dhe me data tani me të marrë këtë pjesën e refuzimit që përmenda pak më lart, që ka mbërritur thashë me datë 15, unë kam bërë një



ankesë për këtë sepse përgjigja që më ka ardhur për mua dyshoj që ka problematika dhe nuk është shteruese. Dhe më pas ankesën që unë kam bërë ja kam drejtuar kryetarit të bashkisë si organi epror i këtij grupi pune dhe i kam kërkuar minimumin një rrespektim me vendosje në dispozicion lista e personave që ka qenë prezent, një procesverbal dhe veprimet që ata kanë bërë dhe përgjigja që më ka ardhur dhe këtë këtë kërkesë unë jam njoftuar me datë 15 e kam bërë me datë 15 nëntor. Mbas tre ditësh me datë 18 nëntor unë i kam bërë ankesën dhe është vënë dijeni dhe në mënyrë elektronike dhe në mënyrë postare dhe përgjigja që më ka ardhur nga bashkia prapë negative nga kryetari i bashkisë më ka ardhur mbas 22 ditëve që është në shkelje të hapur me pjesën e të drejtës së informimit që është jo më shumë se 10 ditë, jo më shumë se 10 ditë. Dhe nga përgjigja që më ka ardhur që unë këtu e kam me numër protokolli më është thënë shprehimisht asnjë lloj përgjigje vetëm më ka dhënë në dispozicion procesverbalin. Tani besoj se nga zyra juridike e bashkisë duhet të ketë besoj se kryetari ka mundësitë dhe aftësitë për të pasur një drejtor juridike dhe për të njoftuar në lidhje dhe mbi afatet dhe afatet që nuk janë respektuar dhe të kthimit të përgjigjes që ne vijmë sot këtu në këtë ditë dhe ngrejmë të gjithë supet që nuk kemi ne mundësi për shkak të afateve sepse kjo është mbledhja e fundit e fundvit ndërkohë që është kërkuar që me datën 18 nëntor pjesa e një risinspektimi të ri sepse edhe këto materiale që unë i vura në dispozicion sot, ja kam bashkangjitur thashë dhe në mënyrë elektronike dhe me foto besoj se jeni në dijeni. Dhe nga përgjigjja e tyre është nuk e di tani nuk e di kush ka qenë motivi, por më është kthyer dhe unë kam marrë njoftim nga posta me datë 11 dhjetor. Bëni vetë llogari tani nga 18 deri më 11 dhjetor.

Edison Memolla . Ta kthej përgjigjen tani ?

Taulant Sula . Po.

Edison Memolla . Ti po pretendon që ne kemi diçka personale me ju?

Taulant Sula . Nuk e di.

Edison Memolla . Po ç'lidhje ka kjo.

Taulant Sula . nëse përgjigja nuk është kthyer në kohë, vijmë në këto kushte tani që unë të kam kërkuar riinspektim aty. Pse s'e ke kthyer përgjigjen?

Edison Memolla . Po s'bëhet ajo ka mbaruar. Pse duhet të bëj riinspektim kur është marrë përgjigje?



Ledian Hasani . Aty janë drejtuesit e bashkisë. Kë do vendosim tjetër? Aty është drejtori i urbanistikës është përgjegjës i urbanistikës, jam unë drejtor. Kë do vendosim tjetër? Tre përfaqësuesve urbanistike.

Hekuran Xhani . Të dëgjova me vëmendje, shqyrr që ne kemi qytetarë që marrin kurajun edhe vijnë e përballen këtu me pushtetin vendor për hallet e tyre. Tashti u shprehe gjatë diskutimit tënd se ti ke edhe dyshime. Këtu unë dua të di për çfarë dyshon ti? Ta kërkoj në mënyrë të singertë q të jemi transparentë edhe me këshilltarët edhe me njëri tjetrin.

Taulant Sula . Në momentin që unë i kam në kuadrin e dyshimeve nuk mundemi dot t'i pasqyroj ato sepse mbeten dyshime dhe nëse pohohet diçka pra, nëse unë do të kem një pyetje pastaj ose pak siç kam ardhur këtu me pjesën e dokumentacionit dhe më pas mbas marrjes së datës 11 dhjetor të kësaj përgjigjeje që do ta quajmë me këtë kuptimin e fjalës përgjigje pa përgjigje të një ankese të bërë, vijmë në kushtet që më pas organi epror mbi kryetarin e bashkisë është këshilli bashkiak dhe këtë unë mundemi t'jua vej në dispozicion edhe çfarë thotë e drejta administrative besoj se...

Edison Memolla . I dimë këto, nuk na i mëson ti sot këto gjëra, po thuaj çfarë keni me thënë.

Ledian Hasani . Kërkesën e parë ta kemi sjellë brenda pesë ditëve kur ke bërë ankeën .

Edison Memolla . Nuk kemi lindur sot, thuaj çfarë ke me thënë ne të dhamë të drejtën të flasësh.

Mukades Gixhari . Ta dhamë të drejtën e fjalës për respekt por jo të na marrësh të gjithë kohën e mbledhjes është mbledhje fund viti kemi plan buxhetin kemi shumë.

Taulant Sula . Absolutisht por unë dua që kjo gjëja të zgjidhet kam ardhur për zgjidhje.

Mukades Gixhari . E dimë hallin sepse ne ishim edhe në shtëpi.

Edison Memolla . Nëse ne nuk do e kuptonim që djali ka hall, nuk do ishte futur në rend dite kjo gjë. Ne jemi të gjithë dakort që çdo gjë të shkojë sipas rregullit, si mbas asaj që i takon. Nuk jemi kundra me askënd se kishim kundra nuk pranonim që sot.

Taulant Sula . Po, puna është këtu meqënëse më pyete drejtpërdrejtë...

Hekuran Xhani . Të kam bërë unë pyetje s'më ke dhënë përgjigje.



Edison Mmolla . Çfarë dyshon?

Hekuran Xhani . Ku dyshon ti? Dëgjo unë të kërkoja transparencë me sinqeritet.

Taulant Sula . Jo nuk e di.

Hekuran Xhani . Ka disa ka disa arsye për dyshim...

Taulant Sula . Po unë në momentin që i kam në kuadrin e dyshimit ... unë jam me profesion oficer policie në momentin që unë e kam në kuadër të pjesës së dyshimit në moment që unë nuk e kam provuar nuk e ...

Erind Tosku . Ledio pse është skualifikuar?

Ledian Hasani . Atëherë ndërtesa nuk është aq e amortizuar saqë të përfshihet në këtë program, ja kam kthyer përgjigjen.

Taulant Sula . Pyetje e drejtpërdrejtë, ku e keni ju një udhëzues të lutem ju bashkë me personat që kanë qenë atë ditë prezentë udhëzues që referoheni duke qenë se ai grup pune i 2021 e ka nxjerrë DS3 këtë.

Ledian Hasani . Pse se ka nxjerrë DS4 si pretendon ti?

Edison Memolla . Atëherë e kanë nxjerrë DS3, ky DS3 me ato ti që ke marrë i bie që ka rënë poshtë ky DS3, është bërë më i mirë se DS3 ke shkuar tek DS0.

Taulant Sula . Po nuk është bërë zero sepse fondi ka qenë i pamjaftueshëm, janë bërë veprimet i kam pasqyruar çfarë punimesh janë bërë.

Silvana Aliu . Taulant do ndërhyjmë ne, atëherë kryetar në momentin që na ka ardhur ankesa ne si këshill bashkiak kemi ngritur një komision ...

Ledian Hasani . Nuk ishte komision vetëm me dy persona s'ishte komision fare jo nuk ishte komision .

Edison Memolla . Anëtari i këshillit bëri një pyetje shumë të mirë. Ore çfarë dyshon? Nëse dyshon që ne të kemi hyrë në hak, ka organe të tjera kompetente që mund t'i ndjek djali i di



shumë mirë sepse bën pjesë atyre, nëse unë drejtorja apo drejtorat...

Taulant Sula . Hallkat jam duke ndjekur ...

Edison Memolla . Ndiqi të gjithë është hallkat Po çfarë problemi kam unë që do të heq ty nga lista, shkurt?

Taulant Sula . Atë e din ti.

Edison Memolla . Unë nuk e di fare që ke qenë ti në listë.

Taulant Sula . Edhe neglizhencë e juaja, nuk e di tani, nuk ma ke kthyer përgjigjen në kohë, kam thënë aty shprehimisht dua një grup tjetër riinspektimi. Ke dhënë vetëm procesverbalin biles ...

Edison Memolla . Ti mund të kërkosh 10 herë grup inspektimi po nuk është e thënë që...

Tulant Sula . Po mundet sa më lejon ligji ...

Edison Memolla . Po pra ligji lejon që...

Taulant Sula . Po ma thuaj që s'takon, pse nuk e shkruan tek përgjigja.

Edison Memolla . Po ta kam dhënë përgjigjen.

Ledian Hasani . Procesverbalin ta kemi sjellë.

Edison Memolla . Nëse do për debat personal të pres në bashki.

Taulant Sula . Nuk është personale jemi këtu në këshill jam qytetar taksapagues i rregullt.

Silvana Aliu . Kemi shkuar në verifikim dhe të gjitha ato ekzistojnë, banesa ishte...

Ledian Hasani . Është banesa si tre banesa që janë kualifikuar? Banesa është si tre banesë që janë kualifikuar?

Silvana Aliu . Nëse do ta dish është njësoj me Latif Dedejin vetëm pllakat ndryshojnë.



Ledian Hasani . Jo nuk ka shanse.

Silvana Aliu . Po flasim Ledi për 22 vende bosh.

Ledian Hasani . Nuk është ashtu. Po pra 22 vende bosh, po kemi përgjegjësi ne për gjithçka që firmosim.

Silvana Aliu . Çfarë përgjegjësie?

Indrit Dedej . Ramë në konkluzion që nga Marsi mund ta rifusim.

Edison Memolla . Nëse rihapet nuk ka asnjë lloj problemi.

Ledian Hasani . Kur të hapen aplikimet të aplikojnë prapë ishalla po ... në qoftë se ndryshon udhëzimi i ministrisë ...

Mitat Daja . Tani ti je skualifikuar për kushte që kanë vendosur këto, pyetja tani drejtoj një pyetje tjetër e Ledit. Bashkia ka pasur një komision për verifikimet, bashkia jo atë ditë që keni shkuar me këshill, pra ka komision është inxhinieri që thotë vendos thotë për skualifikim sepse faktikisht programi është për mirëmbajtje dhe përmirësim i kushteve të banesës.

Ledian Hasani . Atëherë 80% e banesave të bashkisë Rrogozhin se unë kam lëvizur janë si banesa e zotërisë, 80% e banesave se po ta lesh një banesë pa lyer katër pesë vjet normalisht duket sikur është e amortizuar.

Taulant Sula . Atëherë më fal pak, kjo gjuhë që përdor zotëria është një gjuhë jo profesionale nuk është profesionale.

Ledian Hasani . Ti po na ofendon.

Taulant Sula . Nuk është profesionale pra.

Mitat Daja . Edhe unë nuk jam dakort që 80% janë sepse kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka ne po flasim për emrin sepse dhe personi ka është bërë një verifikim dhe ankohet për këtë punë. Me çfarë shoh unë, unë nuk jam as ekspert banesa ka nevojë për përmirësim kushtesh edhe i plotëson të gjitha kushtet, i plotëson të gjitha kriteret. Ai inxhinier që ka bërë këtë lloj vlerësimi që ka thënë që nuk i plotëson atë duhet ta rishikojë dhe herë vendimin e vet. Unë nuk e di nuk flas ...



Taulant Sula . Biles nuk ka pasur asnjë inxhinier ndërtimi tek grupi i punës. Kush ka qenë inxhinier?

Ledian Hasani . Tre janë të zyrës së urbanistikës. drejtori, përgjegjësi dhe një specialist.

Mitat Daja . Atëherë ky komision do bëj një rishikim sepse unë me ca shoh fotografitë dhe një pjesë e këshilltarëve kanë shkuar në vend dhe kanë verifikuar, programi nuk është ndërtim shtëpie duhet ta kuptojmë që t'i dallojmë pak gjërat është përmirësim edhe përmirësimi përmban edhe suvatimin fundja se po marr një shembull shumë të thjeshtë, pra s'ka pse të diskutojmë tani gjëra që është bërë duhet ta rishikojmë këtë vendim. Edhe unë mendoj që të rishikohet dhe mos ngulim këmbë tek bllokimi kësaj gjëje.

Erind Tosku . Unë po thoja që në qoftë se këto pjesë e ankimit, të Taulantit është në të drejtë për një rishqyrtim, për një rikontroll, për një sepse mund të ketë shumë arsye që zotëria pretendon që s'ka qenë në shtëpi okej. Grupi i punës mund të ketë pasur intensitetin e vetë, janë disa kuota afate që mund të pengojnë përfundimin e plotë të kësaj gjëje. Në qoftë se të rishikojmë përsëri, hajde bëhet. Po tani mos eskalojmë në debate, në qoftë se e thashë edhe njëherë edhe familjarët e tjerë në qoftë se ka ajo që thotë edhe zoti Mitat për një suvatim për diçka se kemi kuota të vogla 1 milion lekë që ishte sa ishte këtu 10 milion një familje mund të kemi dhe kuota të tjera.

Ledian Hasani . Po por problemi është që 10 milion nuk është e vogël për ne që mbajmë përgjegjësinë. Është e madhe për ne 10 milion nuk është e vogël. Si? S'po i paguaj nga xhepi, po mbaj përgjegjësi unë për ato.

Mitat Daja . Çfarë problemi ka me e rishikuar.

Edison Memolla . Këshilli po të pyet tani çfare zgjidhje do i japësh. Vitin tjetër të aplikojë prap përsëri.

Erind Tosku . Vitin tjetër nëse ka kuota i bie i bie që shtëpia do degradojë akoma më shumë.

Ledian Hasani . Të aplikojë, e ka penguar njeri zotërinë me aplikuar? Gjithmonë e kam ndihmuar ka ardhur aty i kam thënë bëj këto bëj ato.

Silvana Aliu . Pse nuk shkon në terren njëherë të verifikosh pastaj të bëjë dokumentat pse duhet të harxhojë ai për ato dokumente.



Ledian Hasani . Po pse Ledi i verifikon ato.

Silvana Aliu . Dilni aty mos mos e sillni deri në këtë gjëndje.

Enver Memolla . Kryetare, tani kjo dihet që është një çështje e ndjeshme si për zotërinë dhe për ne nga ana morale dhe njerëzore, nga ana ligjore unë e bëra pyetje dhe dje drejtorit e bëra dhe sot dhe në afatet kohore që përmend zotëria këto sot nuk janë në gjendje për të rishikuar brenda këtij viti. Ajo që unë propozoj si anëtar këshilli në emrin tim personal jo të këshillit që mos të keqkuptohemi është nëse në 2026-ën do rihapet një rehabilitim i tillë propozoj që bashkë me grupin e komisionit ngritur nga kryetari i bashkisë të ngrihet dhe një komision nga këshilli bashkiak në atë kohë kur do rihapet ajo pjesë nëse sot nuk kanë mënyrë ligjore për ta bërë rishikimin që ta bëra edhe dje pyetje. Ky është propozimi që bëj unë që edhe zotëria të marri zgjidhje sepse në këtë kohë me çfarë dëgjova dhe çfarë kam bërë pyetje nuk merr dot zgjidhje sot.

Edison Memolla . Ti kthej përgjigjen shokut, shumë e drejtë ajo që thotë Veri. Ne jemi shumë jemi shumë të kënaqur dhe ju lusim që në këtë komision të bashkangjiteni dhe junuk kemi asnjë lloj interesi, asnjë lloj skualifikimi, sepse fundja fare përfitojnë qytetarët e këtij qyteti edhe në fund fare edhe unë kam një hall më pak për këto familje, kështu që nuk jemi kundër për asnjë gjë, jemi transparent që kjo gjë të bëhet sa më mirë. Nëse do jetë e mundur 26 dhe ju jeni dakort bujrum e ngrejme që sot komisionin.

Indrit Dedej . Kam një mendim që sepse ne Ledi nuk na ka sjellë afatet kështu që mbyllet këtu edhe hapet këtu.

Ledian Hasani . Ledi i ka publikuar afatet dhe ju kam vënë në dijeni të gjithëve. Po Silvana pse i dinte afatet? Silvana i dinte .

Indrit Dedej . Unë propozoj...

Silvana Aliu . Silvana ka dalë në terren për familjet e varfëra.

Indrit Dedej . O kryetar propozoj ai fiton nuk fiton është punë e tij. Marim vendim si këshill bashkiak që ai bashkë me tre familjarët e tjerë që ka Ledi të shtyhet për në Janar dhe të verifikohet bashkë me atë dhe të kalohet kur të jetë e mbledhja ekëshillit bashkiak në Janar.

Ledian Hasani . Nuk nuk kemi afat për të aplikuar në ministri.



Indrit Dedej . Nëse s'ka afate le të digjen dhe ato tjerat.

Ledian Hasani . Digjen tre personat e tjerë sepse nuk kemi afat.

Edison Memolla . As zotëria nuk e don të digjen tjerët , a ka zgjidhje...

Alime Hoxha . Ledio një pyetje kam, tani mesa di unë Taulanti ka kërkuar riinspektimin e ndërtesës. I ka afatet ligjore për t'i bërë riinspektimin.

Ledian Hasani . Po Taulanti kërkon edhe pashë këtu tek kërkesa e këshillit kërkon edhe që mos të jenë nga bashkia ato që do... po të jenë të jashtëm, grupi i punës ta paguaj bashkia nuk jemi këto kushte ne.

Taulant Sula . Sepse ti ke konflikt interesi...

Ledian Hasani . Ky ka thënë që ne s'kemi hyrë në banesë fare.

Taulant Sula . Jo, absolutisht...

Ledian Hasani . E kam tek kërkesa unë.

Edison Memolla . Tani zgjidhja e vetme është çfarë thotë Veri.

Alime Hoxha . Kemi afate për të ngritur komisionin e riinspektimit të ndërtesës?

Edison Memolla . Me aplikim në ministri nuk do të thotë që ne këto tre emra i kemi fituar dhe në ministri. Mund t'i çojmë atje dhe mund të na i refuzojnë...

Alime Hoxha . Dakord për t'i dërguar ne atje sa e kemi afatin?

Indrit Dedej . Kryetare ne e hedhim në votim edhe kjo që them unë kjo do realizohet sepse Ledi nuk tregon afatet.

Alime Hoxha . Ledian kur i ke afatet për t'i dërguar?

Ledian Hasani . Deri më datë 10 janar mund të jenë afat.



Indrit Dedej . Absolutisht, ja fut kot.

Mukades Gixhari . Zoti Indrit të lutem !

Indrit Dedej . Më fal .

Alime Hoxha . Tani të marrim përgjigjen.

Ledian Hasani . Po pse ju jeni të sigurtë që grupi i punës që do vendoset do e cilësojë atë që është...? Nuk na ka vendosur kurrë në presion nuk na ka vendos thënë asnjëherë që bëj këtë apo atë kurrë, na ka thënë punoni vazhdoni kush është e drejta vazhdoni zbatoni ligjin kjo është e gjitha dakord mos...

Alime Hoxha . Ledian po flasim për komisionin për afatet e komisionit për inspektimin që kërkon Taulanti.

Ledian Hasani . E zejmë se kur afatet janë në rregull komisioni jeni i sigurtë që do marrë vendim tjetër ?

Alime Hoxha . Ne ta marrin komisionin nuk është e thënë që ...

Ledian Hasani . Atëherë ne humbim kohën për tre të tjerët.

Alime Hoxha . A e keni afatin deri në 10 janar për t'i dërguar? Tani të ngrihet ai komisioni sa më shpejt kur është për t'u ngritur nuk e di me çfarë ekspertësh do ngrihet për të bërë atë reinspektimin dhe mbledhemi në një mbledhje jashtë radhe dhe i kalojmë... nëse është ky problemi.

Ledian Hasani . Nuk është se kemi kohë...

Edison Memolla . A ka deri në 10? A u mbledhni ju dhe një herë tjetër?

Sokol Gosa . Kryetare edhe ne mos vonohemi kemi dhe çështje të tjera, mendoj që nëse është afati deri në 10 janar një komision tjetër e të mbledhemi muajin tjetër të diskutojmë fut në rend dite dhe problemin Taulantit. Në qoftë se Taulanti i plotëson të gjithë ato kriteret me sa pamë i plotëson ... nuk e di pse është refuzuar nuk e di shkakun cili është shkak, të futet urgjent në janar dhe t'i kalojmë të katër familjet.



Edison Memolla . Profesor unë mendoj që këto të treja t'i kalojnë dhe jashtë radhe mblidhemi vetëm për Taulantin, që edhe mos digjen.

Ledian Hasani . Kalon s'ka problem kaloni këto të treja ngrihet komisioni, ta cilësojë komisioni i takon si takon edhe s'ka problem kaloni këto të treja.

Lije Dedej . Ose të gjithë bashkë ose asnjëri.

Ledian Hasani . Është e sigurtë që do përfitojë Taulanti?

Enver Memolla . Tani duhet të ndajmë një gjë, jemi tek pika pesë, projektvendimi për të tre dosjet e miratuara nga komisioni dhe jemi tek kërkesa e zotërisë për të rishikuar dhe të bëhet mbledhje jashtë radhe vetëm për këtë çështje brenda datës 10 janar. Që i bie ke pesë ti ke vetëm javën e parë të janarit se deri 4 je pushim. Tani propozimi që do bëjmë është do kalojmë këto sot të treja të kalojnë dhe me patjetër bashkia duhet të nxjerri datën e mbledhjes jashtë radhe të këshillit bashkiak...?

Mukades Gixhari . Po do ta nxjerrim ne po.

Enver Memolla . Okej në rregull.

Edison Memolla . Për mendimin tim i kaloni këto treja...

Hekuran Xhani . Unë mora fjalën në fillim dhe për mua kjo pika pestë e rendit të ditës është shumë e rëndësishme sepse thashë e falenderoj qytetarin që paraqitet për ankesë këtu. Po unë aty në fshatin tim kam dy apo tre familje një e ka zgjidhur kryetari e falenderoj. Një familje tepër nevojë, me aftësi të paaftë për punë. Edhe ato janë ndërtuar shtëpiat në vitet 80. Tashti problemi i tyre zotit drejtor është sepse ata nuk janë të aftë dhe s'kanë mundësi t'i nxjerrin certifikatën e pronësisë. Shteti i ka të gjitha zyrat, ka kadastrën, ka hipotekën, i ka të gjitha në dispozicion që ajo shtëpi është ndërtuar, është filmuar edhe nga sistemi i ri tashi i dixhitalizimit të banesave, këto shtëpia janë aty. A mund të zgjidhet problemi i këtyre familjeve? Me një vendim këshilli dhe me një vërtetim njësisë administrative edhe bashkia sepse shtëpia është faktike dhe ne tani i besojmë më shumë letrës sesa faktit që ne...

Edison Memolla . atëherë ne e kemi ngritur një komision nëse ju kujtohet për pjesën e certifikatës për ndihmesën e qytetarëve që të marrin plotësimin e dosjeve, ne realisht kemi dërguar mbi 100 dosje nga bashkia dhe është të dalim tek këto shtëpiat të hyjmë tek këto shtëpiat



që kanë nevojë që të hyjnë në programe të bëhen precedent për më shpejt për përsheptimin e këtyre gjërave. Kështu që marrim angazhim që ne të bëjmë procedurën t'i plotësojmë dokumentacionin këtyre familjeve që kur të aplikojnë mos kenë probleme. Pastaj çertifikata nuk është nuk është në dorën tonë.

Hekuran Xhani . Ato 100 familjet sa është realizuar kryetar nga këto sepse ne kemi ndarë dhe një buxhet nga këshilli.

Edison Memolla . Jo nuk kemi dërguar asnjë gjë, nuk e kaluam.

Hekuran Xhani . Tani një minutë halli i qytetarit është ky, buxheti është më shumë për bashkinë, qytetarët kanë më shumë hall shtëpinë. Dakord? Tashi një minutë, një minutë. Sa nga këto 100 kërkesa që ka paraqitur bashkia për legalizim, sa janë realizuar?

Edison Memolla . Atëherë këto nuk janë përgjigje që do i sjellin të gjithë. Ato duhet t'i kishin sjellë të 100 sepse janë plotësuar dosjet. Realisht sot nuk e di të them numrin fiks sepse nuk e kam.

Hekuran Xhani . A e kupton ku jemi ne? Prandaj them si mund ta zgjidhim problemin e qytetarit ne si institucion vendor, si pushtet vendor.

Edison Memolla . Kryetare sapo të bëra një ndërhyrje që ta bëra për pjesën e pikës pesë dhe ta bëra shumë të qartë për propozimin që të hedhësh në votim. Propozimin do ta bësh që kjo pikë të kalojë për të treja dhe të merret vendim dhe datë të caktuar për zotin Taulant, apo do ta hedhësh në votim që kjo të shtyhet për mbledhjen e janarit? Dhe kjo ky debat është mbyllur. Faleminderit Taulant që ishe ne të marrim vendim si këshill çfarë do bëjmë.

Mukades Gixhari . Po ta hedhim vetëm për zotin Taulant.

Enver Memolla . Një sekondë, se ke dy propozime të parin e ke kanë pesë ditë që kanë marrë njoftimin për pikën pesë dhe kemi dhe ankimimin që pranon të fusim Taulantin. Taulanti me ne mbaroi punë. Tani ne kemi në dorë ke dy propozime nga të dyja palët. Pala tjetër kërkon thotë që pika pesë të kalojë në janar bashkë me ardhjen e dosjes negative pozitive përgjigja, ose të kalojë te pika që kemi përgjigjen kryetares së grupit që kjo pika pesë të kalojë dhe Taulanti të vijë në mbledhje në janar dhe duhet të zgjedhësh ti propozimin tani se çfarë do hedhësh votim të votojmë.



Erind Tosku . Nuk mendoj se do vijë dikush vetëm për një përgjigje negative pozitive, në qoftë se është përgjigje negative në pesë janar të jenë të gjitha banesat njëkohësisht siç them unë që në qoftë se të miratojmë dhe tre familjet ose miratojmë katër familjet e gjithë gjëra të tjera. Unë kështu mendoj.

Enver Memolla . Shtyje në Janar për të gjithë.

Mukades Gixhari . Atëherë të nderuar këshilltarë jeni dakort që këto katër familje të kalojnë në janar në një mbledhje jashtë radhe që do ta bëjmë? Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 14 vota pro, 0-vota kundër, 0-vota abstenim, shqyrtimi në Janar i pikës 5, pas riinspektimit të banesës së znj. Arta Sula.

Mukades Gixhari . Faleminderit.

Taulant Sula . Unë ju uroj punë të mbarë dhe faleminderit.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën gjashtë shqyrtim dhe miratimi i realizimit faktik të buxhetit të vitit 2025 të bashkisë Rrogozhinë. Relaton drejtori i financës zoti Rezart Vogli, zoti Rezart përshëndetje.

Rezart Vogli . Përshëndetje të gjithëve! Ashtu si citoi dhe zonja Mukades Gixhari kryetarja e këshillit bashkiak, unë mbroj buxhetin faktik në këto momente buxhet i cili kaloi dhe dje në këshill në komisionin e ekonomisë. Atëherë buxheti dhe shërbimet e bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025 kanë qenë të orientuara drejt disa shërbimeve bazë dhe jetike për komunitetin nga shpenzimet e kryera gjatë vitit 2025 janë të radhitura shpenzimet për paga. Plani ka qenë 288 milion 829.925 lekë. Nga këto janë realizuar 249.271. 354 lekë. Gjithsej janë realizuar 86.3%. fondi i pagave. Për sigurimet shoqërore ka qenë e planifikuar 664.301.545 lekë është realizuar 56.818.598 lekë ose e përkthyer në 188.3%. Për shpenzime operative të kryera gjatë vitit fondi i planifikuar ka qenë 150.590.876 lekë dhe nga këto janë realizuar 133.933.090 lekë në përqindje 88.97 lekë. Për shërbimet e pastrimit dhe gjelbërimit kosto është e mbuluar në masën 78% nga ana e bashkisë me një realizim faktik...

Mitat Daja . Ne e kemi materialin...

Rezart Vogli . E keni, unë e thashë e kemi materialin e diskutuam dhe dje.



Mitat Daja . A mund të bëj dy pyetje të shpejta. Atëherë ajo që unë vërej tek realizimi i buxhetit faktik ndoshta kjo pyetje është dhe për kryetarin e bashkisë. Të ardhurat nuk janë realizuar në masën për planifikimin e lejeve të ndërtimit, sidomos ne kemi një zonë turistike që normalisht duhet të kesh duhet të kishte një bum lejesh për të investuar në zonë nuk ka kërkesa fare për zonën në Spille? Apo ka një problem, ka ngërç qeveritar që nuk bëhet kjo punë?

Edison Memolla . Atëherë përshëndetje! Është vërtetë që ka interes, por nuk varet gjithmonë dhënia e lejes nga ana e bashkisë. Ka një zonë të caktuar që merret nga Këshilli Kombëtar i Territorit që quhet KKTU tani, dhe është pjesë që nuk merren lejet direkt nga ministria sepse i kanë hequr nga kryeministria sepse e kanë hequr të drejtën bashkisë për një zonë pjesën e bregdetit.

Mitat Daja . Se shoh zonën e Golemit populluar.

Edison Memolla . Atëherë nuk është puna që ne do ta kthejmë si Golemim, ne jemi kundra asaj gjëje.

Mitat Daja . E mora shembull për investimet.

Edison Memolla . Ka interes, por dhe interesi është i limituar përderisa nuk ne i kemi bërë ato investime e duhura siç është rruga, fillojnë ujërat e zeza, energji elektrike, besoj kush ka kaluar ka parë që po ndryshon. Kështu që ka ngelur pjesë e ujësjellësit edhe dëgjoj që ne të paktën infrastrukturën që na takon po e bëjmë.

Mitat Daja . Projekti i dritave energjisë elektrike atje është bërë është bërë sistemim i mirë siç kam parë. Kështu që duhet të ketë kërkesa për investime sepse është për të mirën e të gjithëve.

Edison Memolla . Është me dëshirë s'mund t'i detyrojmë dot investitorët që...

Mitat Daja . E kuptoj, realisht ka kërkesa?

Edison Memolla . Ka kërkesë ka interes por duhet kërkesat duhet të shkojnë konkrete.

Mitat Daja . Dakord ajo është çështje tjetër pastaj.

Edison Memolla . Edhe ne me taksat me ndikimin në infrastrukturë kemi ngelur me taksat e ulëta për të pasur, që të ketë sa më shumë interes kështu që është presim që...



Mitat Daja . Gjëja tjetër është, gjë e mirë është mbledhja e të ardhurave është rritur 6% nga vjet dhe kjo është gjë e mirë sepse është ecje përpara nuk ka regres ka progres dhe drejtoria përkatëse ka bërë punën e mirë. Por se ajo që duhet të thojë unë është ka dhe një problem tjetër, thotë gjithashtu nuk kemi të ardhur nga pronat. Bashkia ka prona, ka asete të veta sepse nuk është e thënë që një bashki funksionon vetëm me taksa, punon funksionon dhe me prona. Ka prona, jep me qera, ku di unë si funksionon, sepse nuk jam ekspert i kësaj fushe, po... pse nuk ndërmerren hapa për t'i vënë në lëvizje këto? Sepse është zhvillim për bashkinë, zhvillim për taksat.

Edison Memolla . Atëherë edhe për këtë ju jap përgjigje sepse nëse ju kujtohet në fillim nuk e di ku ka qenë një mbledhje këshilli kemi sjellë një listë me pronat që bashkia... toka bujqësore pyjore që mund t'i japë me qera që mund të kenë të ardhura. Të gjithë bashkërisht ju keni qenë atëherë kundra kësaj gjëje dhe ne nuk mund ta ...nëse ju do dëshironi apo të gjithë anëtarët e këshillit do kalojnë në janar sepse çdo fillim viti ne e sjellim për miratim nëse do e shikoni të arsyeshme këtu rriten dhe të ardhurat për bashkinë kështu që... është paketa e maleve.

Mitat Daja . Pronat që përfshihen nga pronat nuk janë të gjithë prona private, ka pronë shtetërore.

Edison Memolla . Ka pasur kërkesë për të marrë me qera përderisa ne nuk mund t'i kemi kaluar në këshill sepse është këshilli ai autoriteti...

Mitat Daja . Domethënë ka qenë këshilli pengesë?!

Edison Memolla . Sepse është këshilli autoriteti pronari i tokave po themi që i jep autorizimin kryetarit të bashkisë që pastaj të vazhdojë procedurën

Mitat Daja . Kaq kisha.

Silvana Aliu . Po vetëm një vërejtje Rezi tek buxheti sa më shumë investime.

Rezart Vogli . Do flasim dhe për atë, do flasim për investimet që janë parashikuar për vitin tjetër por ne aktualisht jemi tek faktiku. Nëse duhet të vazhdoj...?

Edison Memolla . Të shkojmë me pyetje kush ka pyetje.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim . Pro, kundra, abstenim. Zonja Lije? Të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.51. Miratohet me 12-vota pro, dokumneti i propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim, me shkresën Nr.5516. Prot, datë 19.12.2025 Relacion “Mbi realizimin faktik të buxhetit 2025”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën shtatë, shqyrtim dhe miratimi i relacionit të buxhetit afatmesëm 2026 për bashkinë Rrogozhinë. Vazhdojmë po me drejtorin e financës zotin Rezart.

Mitat Daja . Rezart ta bëj një pyetje para se të fillosh që t'i kemi gjërat më të qarta sepse materiali është dhe ne i kemi hedhur një sy materialit, pastaj kolegët bëjnë dhe pyetje të tjera. Sa janë investimet e parashikuara nga bashkia për këtë buxhet afatmesëm çfarë do bëhet nga bashkia? Dje kolegu jonë bëri një pyetje të bukur dhe mua më pëlqeu, tha që ore sa rrugë keni planifikuar, me rregullu, me memetuar, sa mure keni mendu me ngrejtur sepse kanë rënë. Duhet të ketë diçka më të thjeshtë sepse shifrat janë shifra.

Edison Memolla . Janë rreth 3.3 km rrugë, po e them që ne pretendojmë me buxhetin afatmesëm që ta që bëhet fjalë për dy apo tre vjet që të bëhet është pjesa e... pastaj janë meremetime pjesa tjetër. Por 3 km mendojmë që brenda dy viteve të bëhen me asfalt.

Mitat Daja . Cilët rrugë janë?

Edison Memolla . Janë aktualisht është rruga lagja mbas ose kinemaja lagjja numër një ose mbi mbi rrugë, dhe janë lagjet e sipër stacionit trenit pastaj të shikojmë kush do hyjë në buxhet sepse lagjja sipër stacionit...

Mitat Daja . Do bëhet investimi këtë vit sepse është...?

Edison Memolla . Po kjo pjesë mbrapa stacionit ka marrë, kjo pjesa mbrapa e bashkisë ose ana e shkollave që janë pjesa ka marrë është bërë studimi është bërë projektimi është bërë kalimi në Institutin e Ndërtimit që ka bërë koalidimin e projektit. Janë bërë të gjithë hapat dhe pritet që të hidhet ... duhet të ishte hedhur, por në janar besoj që do ...

Mitat Daja . Pashë aty tek buxheti, pyetja e dytë dhe pastaj mbaroj unë nuk kam më që është planifikuar një investim për rrugën të lartë, të zonës lart. Dakort është shtuar buxheti dhe mirë është që është shtuar ishte mundësia edhe më shumë më mirë do bëhej që t'u ndante në tre pjesë do ishte shumë herë më mirë sepse ju keni ndarë besoj në dy pjesë, prandaj keni arritur këtë lloj



buxheti. Po nuk ka urbanistika një studim për ndërtimin e këtyre rrugëve, për rregullimin e këtyre rrugëve përfundimisht që të bëhet një zgjidhje më afatgjatë, sepse këto zgjidhje që ne i japim janë zgjidhje afatshkurtra. Edhe urbanistika s'ka një projekt të tillë për të bërë, sepse fundja e funditajte ndoshta s'ka shumë banorë që jetojnë por kanë prona ne kemi përmendur gjithmonë...jo vetëm nuk flasim vetëm për pjesët nga Sinaballaj deri atje edhe Hemenraja edhe Memollaj.

Edison Memolla . Ne kemi urbanistika ka bërë një studim, një plan masash një projektim po themi aq sa kemi hapësirë ne si... kemi bërë dhe aplikime tek fondi shqiptar zhvillimi që ato merren rrugët e bardha quhen ose nuk e di nëse ke dëgjuar dhe ne kemi aplikuar shumë herë tek kjo pjesë dhe shpresojmë që vitin e ardhshëm të jemi nga të parat që të përfitojmë sepse nuk kemi përfituar asnjëherë dhe ajo na jep zgjidhjen që ju thoni sepse është rrugë 12 km e gjatë një nga ato rrugë, me zhavorrim me gjëra është ajo që e merr uji përpara ...

Mitat Daja . Problemi më i madh është lobimi në këto institucione se ju e dini mirë që të lobosh është gjë...nëse duhet ndihma e këshillit për të lobuar, për të marrë investime, s'besoj të ketë njeri kundërshtim për këtë punë.

Edison Memolla . Atje jam pothuajse çdo ditë, kështu që nuk është se ...

Mitat Daja . Ama duhet të jenë projektet e gatshme.

Edison Memolla . I kemi të gatshme.

Mukades Gixhari . I kemi të dyja njëkohësisht edhe tetën.

Erind Tosku . Unë përveç investimit e shoh që sektori më i rëndësishëm për tek pjesa e buxhetit është shërbimet. Shërbimet për mendimin tim janë vënë them jo nuk kemi këtë, jo nuk na del po kështu gjërash. Po mbyllet 2025 rrugët që janë hapur nga ujësjellësi akoma nuk janë mbyllur me asfalt. Kemi llampa të pazëvendësuar, kemi kanalizime të rrugëve, kullueseve nga shira të bllokuara e të tjerë e tjerë që kanë shërbimet. Për mendimin tim shikoni pak më shumë këtë pjesën e zyrës së shërbimeve sepse me të vërtetë po i leni shumë gjëra pa përfunduar. Kështu e shikoj ose do jetë mungesë buxheti ose mungesë infrastrukture, pajisje, gjëra. Në qoftë se do duhen për të rregulluar disa për të fshirë rrugë, një makineri... e marrim domethënë që ta kalojmë tek buxheti në qoftë se duhet. Pra unë këtu e shikoj një çik që të hidhet një sy pjesë e shërbimeve sepse qytetarët kanë nevojë për shërbime vërtetë kanë nevojë për investime, për rrugë, për parqe e tjerë e të tjerë, por shërbimet janë pjesa më kryesore.



Sokol Gosa . Një ndërhyrje kam tek buxheti. Unë mendoj që problem më emergjent që kemi parashikova edhe Rezin për rrjetin elektrik është në gjendje domethënë kryetare skandaloze edhe paraqet një rrezikshmëri tepër tepër tepër të lartë të shkosh në pallatet e Rrogozhinës janë nga kabllot janë të vendosura janë lart një prekje në kontakt nga qoftë nga fëmijë...

Edison Memolla . Rjetin elektrik ndriçues apo rrjeti elektrik furnizues?

Sokol Gosa . Tek pallati im po flas të vish e të shikosh se ke idenë thua si hyjnë këto banorët si jetojnë këtu, aty kalojnë fëmijët të gjithë janë kabulla se smar vesh shumë nga elektriku të presionit e lartë trefazorsha etj, është me të vërtetë emergjente po e them në mbledhje mos na ndodhi larg qoftë o Zot është po them... Edo fute në projekt ndërhyrje urgjente, rrjeti elektrik .

Edison Memolla . Rrjeti elektrik prandaj pyeta nëse është ndriçues është i joni, nëse s'është ndriçues ne do i çojmë kërkesë drejtorisë përkatëse që të marri t'i sistemojë kështu që dakord.

Enver Memolla . Kryetare në lidhje me buxhetin dua të pyes pak sa është fondi total për investimet?

Rezart Vogli . Fondi total për vitin 2026 është 71 milion lekë të reja, nga këto tre projekte janë projekte që nisin nga e para i citoj kryetari më përpara është rivitalizimi i lagjes numër një blloku mbrapa gjimnazit Haxhi Qehaj me vlerë totale 161 milion lekë e cila ka shtrirje e likudimit në tre vite, ndoshta punimet mund të përfundojnë brenda vitit por shtrirjen do ta ketë për tre vite.

Enver Memolla . Për 2026 e ka 40 milion lekë?

Rezart Vogli . 40 milion lekë është fillestari, është rindërtimi i këndit sportiv tek gjimnazi me vlerë totale 7 milion 900.000 lekë dhe ka sistemimin e rrugëve lidhëse të fshatit Sinaballaj loti dy me vlerë totale 12 milion lekë. 60 milion lekë janë parashikuar për investime të reja dhe 19 milion lekë të reja janë planifikuar për likuidimin e borxheve dhe detyrimeve të prapambetura për investimet e kryera ndër vite, kjo është fuqia e bashkisë Rrogozhinë deri këto momente për investime të reja dhe për likuidime.

Enver Memolla . Me fondet e bashkisë?

Rezart Vogli . Me fondet e bashkisë.

Enver Memolla . Po për arsimin parauniversitar dhe parashkollorin është parashikuar ndonjë investim, për çerdhet kopshtet?



Rezart Vogli . Për arsimin është planifikuar një investim i cili lidhet me shkollën e njësive administrative Kryevidh. Për këtë bashkia Rrogozhinës ka bërë kërkesën drejtuar ministrive dhe zyrave përkatëse të linjës dhe po presin financimin nga ana e tyre. Ndërsa për kopshtet dhe për çerdhet e Rrogozhinës nuk ka parashikim për investime të reja, por ka parashikim për mirëmbajtje dhe shërbime operative të cilat në bazë të situatës edhe do të ndërhyhet.

Enver Memolla . Tani buxheti total sa ishte?

Rezart Vogli . Është 935 milion lekë. Ajo që doja të shihja nga ky buxhet do ishte mirë që të paktën sa buxhet i përket Rrogozhinës ai kopshti të bëhej me drekë sepse e shoh çdo ditë situatën që fëmijët tanë që vijnë në shtatë e gjysëm dhe ikin në 12 e gjysëm, ndërkohë që ka dhe prindër që janë të dy në punë .

Edison Memolla . Po është drejtë dhe ne e kemi menduar shumë jemi ulur për të diskutuar por ka dhe një kosto sepse nëse do t'i mbash për drekë nuk do t'i bësh të jesh koherentë si çerdhen edhe kopshtin. Kemi kërkuar hapësira që realisht nuk i kemi si bashki sepse dhe të marrësh një hapësirë që nuk i vlen fëmijëve të vegjël duhet të marrësh hapësirë që të jetë e thatë të jetë e ngrohtë që të ketë disa kushte. Kjo është gjëja që do, është e mirë po duhet me... edhe përgjegjësia është dhe më e madhe sepse gatimi në institucion duhet të ketë edhe ato kushtet e veta, sepse nuk mund të gatuajmë dhe të na ndodhi të helmohen fëmijët dhe janë gjëra shumë me përgjithësi dhe duhet me u menduar mirë para se të veprojmë për këtë gjë. Ne jemi të disponuar që ta bëjmë me drekë sepse e di që shumica e njerëzve janë edhe burrë e grua në punë dhe nuk kanë ku ti lenë fëmijët, kanë prindërit e gjyshërit e vjetër, nuk kanë më mundësi, janë të sëmurë. Kështu që kjo është një gjë që gjatë vitit besoj që do kemi edhe ato kontaktet edhe gjithë bashkë hajde ta shikojmë se dakort jemi që të bëhet do të bëhet edhe më e mira kur të bëhet.

Erind Tosku . Në qoftë se s'postoni çerdhen në qoftë se...

Edison Memolla . Nuk kemi gjetur një ambient të mirëfilltë për çerdhen.

Enver Memolla . Kryetar diçka për sa i përket pjesës së shërbimeve të jeni pak më korrekt me ndërhyrjen në punët e bëra sepse thashë unë para një muaji kam ngritur një problematikë drejtpërdrejtë për dy gjëra dhe akoma nuk ...

Edison Memolla . Për pjesën e ujit atje, po e di.

Enver Memolla . Dhe akoma nuk është zgjidhur dhe uji atje edhe këtu. Disa gjëra të vogla që bëjnë shumë pak punë dhe duhen bërë.



Edison Memolla . Ju shumë mirë që i ngreni këtu po janë disa gjëra që nuk varen gjithmonë nga bashkia, kanalizimet ju e dini që ka kaluar ...ujësjellës kanalizime kanë shkuar diku tjetër. Kemi marrë një mjet me qera që të vijnë ta bëjmë sepse ka një bllokim ajo atje rruga realisht është e rrezikshme edhe nuk mund të rrjnë ato ujëra .

Enver Memolla . Ka dhe një rrezik sot jemi në kushte jemi në dimër që mbushet me ujë por aty ka dhe ujëra të bardha dhe ujëra të zeza.

Edison Memolla . Atë po them që ka rreziqe edhe shëndetësore, duhet një ndërhyrje më eksperte e gjësë.

Enver Memolla . Jo të kishin këtë tendencën nëse duhet më shumë fond për shërbimet, shërbeji rriti fondin e shërbimeve këtë po them.

Sokol Gosa . Nuk e di kemi kaluar kryetar dhe një projekt për një zhvendosje të bashkisë dhe një vend tjetër ku mund të vendoset se mua më vjen keq që paguhemi me dhjetëra milion lekë ambiente të ndryshme me qera, privatë. Edhe ne të mos kemi mundësi të kemi një godinë tonën të bashkisë.

Edison Memolla . Ne e kemi bërë projektin e kemi kaluar dhe në këshill, këshilli i kaluar për godinën aty i kemi bërë të gjithë hapat që i takojnë.

Sokol Gosa . Pastaj lirohet ai objekti edhe për çerdhen për kopështin bëhet me drekë bëhet me të gjitha por objekti duhet se s'bën.

Edison Memolla . Ai objekt është që ju e keni ngritur shqetësin dhe vërtetë ashtu është që është i lënë në harresë aty. I kemi bërë të gjitha edhe këshilli bashkiak i kaluar besoj nuk e di ka qenë kemi marrë një vendim për prishje, risistemim, kalim projekti, fondi, kemi bërë të gjithë kërkesat, por edhe duhet një fond i konsiderueshëm me e bërë sepse realisht... nuk mund t'i dërgojmë fondet që kemi aktuale të bëjmë një godinë po themi...

Mitat Daja . A nuk është mundësia për punë punën e çerdhes me marrë një ambient me qera të mirë?

Edison Memolla . Kemi kërkuar ambient me qera por do duhet të jetë edhe i aksesueshëm nuk mund të marrim një objekt... Nuk kemi gjetur në qendër të qytetit se duhet të jetë dhe i madh se nuk mund të jetë... Po tani po flasim për 200 m një ambient 200 m govinë dhe nuk po e gjejmë.



Kemi kontaktuar ato që janë mbas bashkisë është njëri aty por dhe duhet rënë dakort sepse do të bëhen edhe ndërhyrje, disa nuk janë dakort për ndërhyrje, disa thonë lëre siç e kanë. Po deshe merre kështu, me një fjalë janë shumë gjëra sepse duhet dhe në qendër se ai do sjelli fëmijë nuk mund ta çojë, kemi kërkuar të gjithë qendrën e qytetit nuk kemi gjetur një qendër që të jetë mbi 200 m hapësirë sepse nëse do ta bëjmë me drekë do të ketë kuzhinën do të ketë tualetet do të ketë ca rregulla standarte, dhomën e fjetjes dhomën që do rrinë do lozin.

Mitat Daja . Edhe për një gangrenë tjetër që është në qytet domethënë ato ato ndërtesat tek parku po nuk gjen atë mundësi për t'i mbyllur ato? Edhe privatisht mund të ishin bërë.

Edison Memolla . Atëherë pjesa e poshtme janë në proces gjyqësor.

Mitat Daja . Mbylle s'po të thotë njeri bëji gjë. Po detyroji bëji një mur bëj një avlli, ato janë gangrenë dhe problematika më e madhe sot për sot në qytet.

Edison Memolla . Tani ta mbyllësh është dhe një çik përgjegjësi e njerëzve se s'mund shkosh në mes të qytetit.

Mitat Daja . Unë dal rrallë aty por aq rrallë sa dal aty është fatkeqësi e madhe.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë dhe pak z. Hekuran Xhani.

Hekuran Xhani . Ky fondi i investimeve për 2026-ën do të shkojë për tre projekte dy nga Rrogozhina dhe një nga Sinaballaj sipas parashikimit...

Rezart Vogli . 60 milion e fondit, fondi në total është 71.904.833 lekë ose më sakt 14% e buxhetit shkon për investime.

Hekuran Xhani . Plotësisht dakort, po i gjithë investimi do të jetë për 2026-ën tre projektet kryesore, 60 milion ngelin ...

Rezart Vogli . Nga fondet tona, se gjatë vitit presim dhe rialokime fondesh për projekte që bashkia Rrogozhinë ka bërë kërkesa.

Hekuran Xhani . Tashi unë kam bërë një kërkesë për një rrugë atje lidhëse varrezës sepse ajo është bërë e pakalueshme për mjetet. Edhe faktikisht unë mendova se do të kishte një farë...



Edison Memolla . Duke mos ...sepse fondi shqiptar i zhvillimit jep asfaltim herë pas here mos harxhojmë fondin e bashkisë që kur mund ta marrim aplikim tek një fond tjetër që ne këto fonde t'i çojmë aty ku nuk i marrim do. Kështu që është marrë gjithë ajo kërkesa juaj dhe disa varrezave të tjera që janë dhe është bërë dhe projekti i aplikuar te fondi shqiptar i zhvillimit në momentin që vitin e ardhshëm hapim aplikimet edhe do shkojmë do shkojmë me këto rrugë. Edhe në zonën tuaj është menduar dhe një rrugë tjetër që e ka bërë prapë qarku, këshilli i qarkut që mund të lidhet rruga e drejtë që dilni direkt te rruga e Vilës. Akoma jemi në diskutim ...

Hekuran Xhani . Atë e kanë propozuar...

Edison Memolla . Jo është me shumë mundësi që mund të realizohet vitin e ardhshëm por po e mbajnë si rezervë.

Indrit Dedej . Kryetar, hyrja në Sinaballaj duhet parë sinjalistika.

Edison Memolla . Nuk ndërhyjmë dot ne, ARSH po bën riasfaltim të gjithë zonës, në dijeninë time do i bëjnë dhe vizimet e gjithë gjërat ose tabela . Ne zgjerimin ju e patë me shumë mundim e realizuam.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim është pika shtatë dhe tetë. Atëherë hedhim në votim miratimin e buxhetit të bashkisë Rogozhin për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028. Pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, projektvendimi me Nr.5551. Prot, datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028", Relacioni me Nr. Nr.5517.Prot datë 19.12.2025 "Për diskutimin dhe miratimin e Projektbuxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025", së bashku me tabelat shoqëruese pjesë përbërëse të këtij dokumenti, dhe Relacioni me Nr.5518.Prot datë 19.12.2025 "Mbi diskutimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028".

Vendim nr. 52 . Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr.5551. Prot, datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028", Relacioni me Nr. Nr.5517.Prot datë 19.12.2025 "Për diskutimin dhe miratimin e Projektbuxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025", së bashku me tabelat shoqëruese pjesë përbërëse të këtij dokumenti, dhe Relacioni me Nr.5518.Prot datë 19.12.2025 "Mbi diskutimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028".



Mukades Gixhari . Faleminderit zoti Rezart. Kemi akoma punë bashkë nuk do largohesh. Kalojmë në pikën nëntë miratimi i projektvendimit për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar. Relaton drejtori i arsimit kulturës rinisë dhe sportit turizmit zoti Orges Tosku. Përshëndetje zoti Orges.

Orges Tosku . Atëherë përshëndetje të gjithëve. Ministria e Arsimit çdo vit të ri shkollor sjell planin për bursën e arsimit parauniversitar për nxënësit që plotësojnë të paktën një nga kriteret sipas VKM-së 666. Ministria e Arsimit për vitin shkollor 2025-2026 për bashkinë Rrogozhinë ka sjellë 20, nga aplikimet që kemi pasur pranë bashkisë kemi 42 nxënës, 20 bursa do të mbulohen nga Ministria e Arsimit, pjesa tjetër do të mbulohet nga buxheti i bashkisë Rrogozhinë. Krahasuar me një vit më parë, kemi një rritje të dhënies së bursave jo nga Ministria e Arsimit sepse edhe vjet ka qenë 20 por nga ana e bashkisë që vjet ka qenë 12, këtë vit është bërë 22, dje shtuam edhe atë emrin që ramë dakord tek komisioni arsimit.

Mukades Gixhari . Zonja Silvana Aliu fjala për ju.

Silvana Aliu . Atëherë i drejtohem gjithmonë kryetarit meqë është dhe viti i ri në Luz kemi një familje që e kemi harruar për vullnet a nuk e di ... A mundet

Orges Tosku . Atëherë ne ishim dje e shtuam atë emrin, të kishte ardhur dje ky emri...

Edison Memolla . O Vis mund të ndryshojë kjo? Ka një propozim një emër tjetër a mund të shtohet tek kjo lista? Sa e kemi afatin?

Orges Tosku . Nuk e bëjmë dot, sot mbyllet me 31 Dhjetor. Nuk është pengesë nga ne deshët një emër dje e futëm.

Hekuran Xhani . Dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë familje nuk mund... muk është hera e parë që trajtohet ky problem edhe znj. Alime ka marrë përsipër me drejtorat e shkollave familjet që përfitojnë duhet të sjellin listat sepse unë e kisha sjellë vetë atë emër. Tani pra që t'i përmbahemi fjalëve që kemi thënë tani është gjynah kryetari e njeh gjendjen e asaj familje sepse ka kontribuar me fondet e bashkisë i ka rregulluar shtëpinë që unë e kam falenderuar publikisht edhe këtu edhe atje ku janë, është gjynah që ai të mos të futet.

Orges Tosku . Por duhet adresuar problemi se nuk jemi ne problemi ne shkresë drejtorëve i kemi çuar edhe drejtoria arsimore është në dijeni.



Hekuran Xhani . Ti nuk e ke mbyllur vendimi merret sot.

Orges Tosku . Do sjelli dokumentet si do e bëj unë, kriteret.

Hekuran Xhani . Ja sjell unë dokumentet çfarë dokumenti duhet shkoj ja marr unë.

Orges Tosku . Pse nuk e solle ti.

Hekuran Xhani . Unë e di që e ka marrë përsipër Alimeja këtë punë. nëse nuk bëhet nëse

Fatmira Thartori . Nuk e kisha në kundërshtim me pjesën e emrave që do shtohen por propozimi ishte që të bëhet një projektvendim i ri me emrin e ri që erdhi dhe të miratohet pra të dy, pra dy shtesa nuk ishim kundra nuk jam kundra.

Alime Hoxha . Tani ne kemi një kemi bërë dhe një propozim të tillë që për atë nxënësin që ndoshta nuk i është futur emri aty ne kemi drejtë si këshill që i japim 500.000 lekshin si ndihmë të menjëhershme dhe kompensot.

Hekuran Xhani . Shumë dakort, jam në rregull.

Edison Memolla . Në mbledhjen e ardhshme krijojmë projektvendim të ndihmës së menjëhershme.

Hekuran Xhani . Jam plotësisht dakord. Shefi i financave është dakord?

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pikën 9-të. Pro kundra abstenim, të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 9 (nëntë) e rendit të ditës.

Vendim nr.53. Miratohet me 16- vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë, me shkresë Nr.5457.Prot datë 16.12.2025 “Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar“, si dhe relacionin e këtij projekt-vendimi me Nr.5457/1.Prot datë 16.12.2025, si dhe projektvendimi me Nr.5457/2.Prot dhe Relacioni i këtij projektvendimi me Nr.5457/3 datë 23.12.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 10, të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Bursave të nxënësve të arsimit profesional”. Fjala po për drejtorin e Arsimit,



Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Turizmit z. Orges Tosku.

Orges Tosku . Atëherë këto janë bursa që vijnë nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për vitin shkollor 2025-2026 ka sjellë 15-kuota nga aplikimet që ne kemi pranë bashkisë janë 11, kanë përfituar të gjithë.

Hekuran Xhani . Sa më shumë bursa aq më mirë është.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pikën 10-të, të rendit të ditës. Pro, kundra, abstenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 10 (dhjetë) e rendit të ditës.

Vendim nr.54. Miratohet me 16- vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me shkresë Nr.5458.Prot datë 16.12.2025 “Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit profesional“ si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5458/1.Prot datë 16.12.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 11. Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026”.

Alime Hoxha . Programin e këshillit ne e kemi diskutuar dhe në komisione ne jemi dakord nuk e di nëse ka ndonjë diskutim...

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pikën 11-të, të rendit të ditës. Pro kundra abstenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 11 (njëmbëdhjetë) e rendit të ditës.

Vendim nr.55. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetarja e Këshillit, me shkresë Nr.5491.Prot datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026“, si dhe Relacionin e projektvendimit me shkresë Nr.5491/1. Prot datë 18.12.2025.

Mukades Gixhari . Jemi në pikën 12, Miratim i projekt - vendimit, “Për shpalljen qytetar nderi Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj”. E kemi diskutuar dhe par dy mbledhesh.



Mitat Daja . T'i them dy fjalë, është diçka domethënë e mirë faktikisht që ne na jepet një mundësi që ai është presidenti i republikës nuk duhet të marrë ngjyime politike tani kjo punë, pavarësisht se është vendas është nga është nga pjesa e bashkisë së Rrogozhinës edhe unë nuk mendoj që duhet shtuar ose duhet shty se është shtyrë nga dy tre herë kjo punë, është mirë që ne të paktën të krenohemi që kemi pasur një president nga Rrogozhina pastaj me gjykimin do i ngelë secilit më vete mos e bëjmë më shtyrje herë pas here. Kështu që të hedhim...

Mukades Gixhari . Atëherë jeni dakord që ta hedhim në votim?

Sokol Gosa . Jo.

Mukades Gixhari . Zoti Sokol Gosa.

Sokol Gosa . Kam unë kryetare, meqë kam qenë dhe tek komisioni dhe më hoqën, shumë mirë e bënë sepse shqyr do ta filloja mbrapsh atë me vendime ndoshta nga ato që kanë shikuar vetë. Nuk mund të vlerësojmë neve figura historike të qytetit tonë, bashkisë tonë njerëz që nuk kanë kontribute. Qytetar nderi është një vlerësim maksimal më i madhi për mua prandaj dhe kur isha tek komisioni kur isha kryetar u tërhoja, nuk vendosja plus situata që nuk u plotësoi numri pesë... por ama të vlerësosh me titull qytetar nderi do të matesh 100.000 herë çfarë kontributi ka ai person, çfarë ka bërë për këto komunitet, çfarë ka bërë për këtë qytet... Ka bërë një shkollë, ka bërë një rrugë, ka bërë një urë, ka mbrojtur interesat e qytetit, komunitetit ku është? Jo kot, jo kot aty ka dhe tituj të tjerë ka mirënjohja e tjerë me radhë, jo qytetar nderi është vendimi më final më erdhi shumë keq që e mora vesh sot, që është shpallur qytetar fillojnë me një person. Jo mos biem në këtë kaq ulët në këtë nivel për interesa personale nuk e di. Kemi pak përgjegjësi si këshill. Ne për herë të parë kemi ngritur komision për vlerësimin e figurave edhe ne ta fillojmë në këtë mënyrë ? Jo absolutisht jo, ka thashë tituj të tjerë që mund të jenë, ne duhet të vlerësojmë figurat e qytetit që kanë kontribuar në vite këtu e 100 vjet në histori, në art, kulturë e të gjitha fushat. Ndërsa kjo ishte që doja me thënë se s'bën nuk mund ta lija dot, ndërsa për këtë presidentin unë jam kundër absolutisht kundër të jetë jo president i republikës, por të jetë dhe presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në qoftë se nuk ka një kontribut për qytetin tonë, jo të shkojmë mbrapa partive e tjerë e me radhë. Unë jam kundër.

Indrit Dedej . Unë si anëtar i komisionit të pastërtisë së figurave për aq sa kam dhënë i kam dhënë një figure që i ka dhënë këtij vendi nuk ka rëndësi koha sepse unë para se të marr vendim unë edhe pyes, marr informacion edhe mëson fjalë që kemi dhënë edhe vendimin qytetar nderi ka kontribuar në luftën çlirimtare ndërmjet viteve 41-45 edhe e njeh jo një zonë por e njeh i gjithë rrethi. Unë nuk flas i shërbyer kujt i ka shërbyer mbrapa ... për sa si anëtar i komisionit që jam



për këtë lloj figure nuk e tërheq kurrë dhe e meriton për qytetar nderi. Për presidentin e vetmja gjë është që nuk kemi parë kontribut se edhe ne si qytet, i zonës tonë është një farë kontributi mund të jepte, unë kam qenë kundra realisht.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim.

Hekuran Xhani . Me leje.

Mukades Gixhari . Po z. Hekuran.

Hekuran Xhani . Mos u nxito se nuk janë vendime të vogla këto zonja kryetare, këto janë vendime të mëdhaja dhe vendime historike. Lidhur me problemin e dhënies të titujve të nderit ose qytetar nderi të bashkisë Rrogozhinë, komisioni pranë bashkisë dhe pranë këshillit duhet të merret me fakte historike dhe të vlerësojë kontributin e gjithsecilit dhe t'i japi gjithsecilit atë çka meriton. Muaji nëntor është muaj i festave për të gjithë Shqipërinë, Rrogozhina filloi me 13 nëntor festoi çlirimin e saj si qytet. Shumë bukur nder dhe lavdi të gjithëve atyre burrave që dhanë gjak e djersë për çlirimin e Shqipërisë por unë kam paragjykimet e mia lidhur me këtë çështje sepse figurat historike të bashkisë nuk janë vetëm në qytetin Rrogozhinë por janë pothuajse në të gjithë periferinë. Lidhur me çështjen e luftës nacional çlirimtare çka lidhet dhe me çlirimin e Shqipërisë. Shqipëria është pushtuar më 7 prill 1939 dhe në atë luftë ka pasur edhe nga bashkia Rrogozhinë qytetarë e komandantë që kanë luftuar me Mujo Ulqinakun për mospushtimin e Shqipërisë. Pastaj filloi lufta për çlirimin, pra lufta filloi në 39 për ta mbrojtur nga pushtimi. Megjithatë këto figura unë këtë në bashki për dy vjet s'kam dëgjuar asnjë.

Indrit Dedej . S'kemi pasur kërkesa.

Hekuran Xhani . Vijnë tani komisioni duhet të merret historik, ka komision bashkia që merret me këto... Indrit ta mbaroj. Pastaj vijnë festa e pavarësisë festë kombëtare. Unë po e lidh problemin tim me dy figurat, tre figurat që ka fshati im në kontributet historike të Shqipërisë dhe jo të bashkisë. Megjithatë bashkia asnjë nga këto tre figura nuk i ka investiguar këto komisionet e famshme që kemi ne për verifikimin e figurave. Më 1912 Bajram Xhani ishte komandanti i regjimit quhej në atë kohë Shijak, Durrës, Kavajë dhe Peqin. Ai burrë e priti Ismail Qemalin, është shkruar dhe në librat e historisë dhe ai e ka kaluar deri në Vlorë me ushtrinë e vet sepse ishte luftë edhe askush në këtë bashki... pra një kontribut patriotik atdhetar kombëtar. Këtu në bashki unë s'kam dëgjuar asnjë fjalë nga këto komisionet historike, nga këto shoqatat që merren me historinë. Më 7 prill që unë e trajtova 1939 plaku Hamit Leçini me 300 burra shkruajnë librat e historisë shkon dhe lufton përkrah Mujo Ulqinakut në Durrës për mos pushtimin. Po kështu në



konferencën e Labinotit në Elbasan, Baba Faja Martaneshi Xhani nga fisi im, zgjidhet zëvendës shef i shtabit të përgjithshëm të luftës nacional çlirimtare ku komandant i shtabit ishte Enver Hoxha. La detyrën që kishte ose hapi dyert e faltore ku ai shërbente edhe u bë pjesë e luftës, asnjë vlerësim nga ky... Tani lidhur dhe me shoqatën e veteranëve të luftës së bashkisë drejtimin e saj unë jam siç thotë Cezari gjithkush mori hakun e vet. Ne kemi familje që kanë mbajtur barrën e luftës në bashki, unë njoh një ndër këta familja Behexhet Beut / Harizit ka derdhur dhe gjak mirë a keq tani unë nuk e shoh në krye të drejtimit të kësaj. Pra, le ta drejtojnë ato çka kanë kontribuar lidhur me misionin e vet historik që kanë. Për sa i përket presidentit unë e thashë edhe në mbledhjen e parë, unë do të isha plotësisht dakort në rast se atij do të jepesh një titull qytetar nderi si mjek për kontributin që ka dhënë në mjekësinë shqiptare, në shërbim të qytetarëve edhe të bashkisë në Rrogozhinë. Për sa i përket çështjes si president, unë nuk jam dakord. Unë e kam thënë shkurt se në këtë rast do ta bazoj dhe në fakte. Sot unë jam me Hekuran Xhani dhe vij nga fshati Luz i Madh. Në 2015 kemi qenë afërsisht 4000 banorë si fshat nuk po rendis numrin se sa jemi sot. Po të dashur këshilltarë e dashur qytetarë të bashkisë Rrogozhinë, ju njoftoj me hidhërim të madh, kemi 18 vdekje në një fshat dhe s'kemi asnjë lindje. Edhe duke parë këtë realitet sy për sy jam kundër çdo politikani që ka kryer aktivitet politik për 35 vjet për gjendjen ku ndodhet në radhë të parë katuni im edhe Shqipëria. Askush nga këta që kanë veshur petkun e politikës nuk meritojnë asnjë dekorim përveç marrjes së përgjegjësisë dhe dhënies së llogarisë përballë qytetarëve për këtë gjendje që sot ndodhet Shqipëria. Ne sot kemi gjysmën e popullatës jashtë vendit. E çfarë merite ka ky president apo ai kryeministër apo ai ministër, kultura apo arsimit ku politikat janë në shërbim të pushtetit dhe jo të qytetarëve. Unë jam kundra dhe do të votoj kundra jo për presidentin, por për cilindo politikan që është pjesë e kësaj qeverisje famëkeqe të kombit shqiptar. E ju njoftoj edhe njëherë që një fshat me 4.000 banorë sot nuk ka asnjë lindje dhe ka 18 vdekje. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit zoti Hekuran, zonja Fatmira Thartori.

Fatmira Thartori . Sa për titullin e presidentit jam plotësisht e mendimit dhe të jemi edhe ne krenar që është një president që është zgjedhur nga komuniteti jonë që na përfaqëson ne...

Hekuran Xhani . Se ka zgjedhur komuniteti sa e ka zgjedhur partia zonjë dhe nuk votoj kandidat partie as patronazhista

Fatmira Thartori . Unë të dëgjova zotëri dhe të respekova, tani të lutem unë të respektova të dëgjova deri në fund nuk kundërshtova askënd.

Hekuran Xhani . Faleminderit kryetare , mirupafshim



Fatmira Thartori . Tek kjo pjesë ne duhet patjetër që të vlerësojmë një figurë që i përket komunitetit tonë, të jemi krenarë të ndjehemi krenarë që nga komuniteti jonë është zgjedhur një president që drejton të gjithë këtë vend. Jam plotësisht dakort që të miratohet si qytetar nderi, sa për pjesën tjetër të pastrimit të figurave kemi qenë pesë vetë në komision dhe ishim që të gjithë dakort për atë që është miratuar më parë në mbledhjen tjetër. Dhe kemi parë çdo pikë duke i marrë me përpikshmërinë më të madhe që të gjithë pikat ishin dhe që të gjithë anëtarët ishin dakort që t'u bënte qytetar nderi. Sa për pjesën e komisionit tjetër i ka dhënë faktet që s'ka bërë asgjë. Mirupafshim. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? E hedhim në votim. Vota pro, kundër, abstenim. Miratohet me shumicë votash.

- Miratohet me 8 (tetë) vota pro, 5 (pesë) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 12 (dymbëdhjetë) e rendit të ditës.

Vendim nr . 56 . Miratohet me 8-vota pro (shumicë e thjeshtë) projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4358.Prot datë 10.10.2025 “Për shpalljen “Qytetar Nderi” Presidentit të Republikës së Shqipërisë SH.T.Z Bajram Begaj”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4358/1.Prot datë 10.10.2025.

Silvana Aliu . Me çfarë shumice, ku e ke 11-en?

Mukades Gixhari . Jemi 8, kalon me shumicë.

Ervis Shera . Sipas ligjit.

Silvana Aliu . Ku aty ku do ti? Absolutisht kundër është 11 bëjeni.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën tjetër, shqyrtim i dy kërkesave të anëtares së këshillit bashkiak znj. Silvana Aliu.

Silvana Aliu . Ti po shkel ligjin po shkel rregulloren që i takon kësaj... ku i ke 11? Të gjithë kalojnë me 11 vota ku i ke 11?

Indrit Dedej . 50+1.

Ervis Shera . E thotë ligji.



Silvana Aliu . E thotë ligji kur do ti se ligjin e ke interpretuar kur ke dashur ti.

Indrit Dedej . Ligjet që bën ti Viso...

Silvana Aliu . Do e shohim.

Ervis Shera . Unë nuk bëj ligje.

- *3 këshilltarë të opozitës largohen nga mbledhja znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, znj. Lije Dedej.*

Mukades Gixhari . Kemi dhe një projekt vendim shtesë për miratimin e kalendarit.

-Mbledhjes i bashkohet z. Mitat Daja.

Mitat Daja . E miratuat direkt ju?

Mukades Gixhari . Ju ishit pro apo kundra?

Lulzim Hasa . Ky u deklarua pro.

Mitat Daja . Unë pro e deklarova që në fillim.

Mukades Gixhari . Pro, ok.

Mitat Daja . Është bërë shumë paragjyqese ky lloj fakti dhe nuk duhet t'u sillte deri në këtë lloj forme. Jo, është gabimi dhe aty edhe atyre që e sjellin pa u konsultuar mirë. Unë nuk e di ajo s'ka pse të diskutohet se është gjë jo normale që të diskutohet po edhe ata që ja sjellin për mua kanë bërë gabim shumë të madh që ja sjellin në këtë lloj forme.

Alime Hoxha . Pataj Hekri ishte në mbledhje këshilli jo në mbledhje partie duhet t'ia ndërprisje fjalën mos e ndërprisnim ne nuk do vazhdonte Hekri se çfarë kishte si donte Hekri në kishim mbledhje këshilli jo mbledhje partie.

Mukades Gixhari . Figurat historike...

Fatmira Thartori . Ka një komision duhet ta adresoj në komision Hekri atë pjesën dhe s'ka pse



e thotë të gjithë pjesën ta marrë gjithë kohën e këshillit.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek projekt vendimi i kalendarit për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2027-2029 dhe buxheti vjetor zoti Rezart Vogli drejtori.

Rezart Vogli . I kam paraqitur këshillit bashkiak projekt vendimin për miratimin e datave dhe afateve për të përmbushur kriteret ligjore për përgatitjen e buxhetit afatmesëm ky është viti i parë... projektvendimi thjesht ka të përcaktuara datat dhe kur do të vijë në këshill bashkiak informacionit dhe dokumenti për buxhetin afatmesëm.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për këtë projektvendim?

Rezart Vogli . Projektvendimi ka për qëllim që bashkia Rrogozhinë, grupi i menaxhimit strategjik, personat përgjegjës t'i përmbahen afateve dhe kushteve sipas përgatitjen dhe relativitetit dhe në fund fare miratimi projektbuxhetit afatmesëm. Ai diskutim dhe ai shqetësim që ka e ka thënë këshilli herë pas here këtu që nuk na ka ardhur dokumenti në kohë me këtë projektvendim vihem përpara përgjegjësisë...

Mukades Gixhari . E hedhim në votim.

-Mungon kuorumi pasi z. Mitat Daja largohet nga mbledhja (10 këshilltarë prezentë në sallë).

Rezart Vogli . Atëherë gjatë kohës që vjen zoti Mitat ka për të relatuar dhe pjesën e performancës së bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024. Flasim për një kohë në përgjithësi bashkia ka bërë përparime në disa fusha, ka nevojë për angazhim të vazhdueshëm për të adresuar pikat që mbeten. Në lidhje me arsimin është rekomanduar rritja e numrit të edukatoreve rekomandohen investime në infrastrukturën arsimore dhe monitorimin e vazhdueshëm të treguesve të aksesit dhe cilësisë, menaxhimi i mbetjeve.

-Mbledhjes i bashkohet z. Mitat Daja.

Mitat Daja . E lejmë herën tjetër.

Mukades Gixhari . Jemi tek kalendari ta hedhim në votim edhe...

Mitat Daja . E lejmë për herën tjetër këtë kalendarin... tani njeriu mbahet dhe nga fjala. E lejmë për herën tjetër kalendarin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Mukades Gixhari . Atëherë meqë nuk kemi gjë për të diskutuar. Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 30⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 01 orë 50 min ; 50 sek.
- Ky procesverbal i mbyllet në faqen **45 (dyzet e pesë)**.

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera

**KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI**